



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:047444

Datë: 10.07.2024

Numri i dokumentit: 05920438

K.DH.SH.II.nr.972/24

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**- Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar, Dren Rogova dhe Faton Bajrami, anëtar te kolegjit, sipas padisë së paditësit “në çështjen juridike të paditësit Pandora AIS, me seli në Danimarkë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve Vokshi&Lata, me seli në Prishtinë, kundër të paditurit D.P.Z "Bylbyli", me NUI: 810579972, me seli në Prizren, rruga "Adem Jashari" nr.2, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Durim Nevzati nga Prizreni, me bazë juridike, Shkelje e Markës Tregtare, duke vendosur lidhur me ankesën e te paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkalles se pare-Departamenti Ekonomik, KE 2634/22 të datës 25.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.07.2023, merr këtë:

### AKTVENDIM

**APROVOHET** si e bazuar ankesa e paditësit Pandora AIS, me seli në Danimarkë, ndërsa **PRISHET** Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkalles se pare-Departamenti Ekonomik, KE 2634/22 të datës 25.12.2023, dhe lënda i kthehet Gjykatës Komerciale, dhomave të shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

### A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykata e shkalles se pare ka vendosur, Refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit Pandora AIS, me të cilën ka kërkuar që të konstatohet se pala e paditur D.P.Z "Bylbyli", ka shkelur markën tregtare "Pandora", me numër 013262, 018214 dhe 018068, si dhe t'i ndalohet të paditurit përdorimi, importimi, eksportimi, vënia në treg e çdo produkti që përmban shenjë identike apo të ngjashme me markat tregtare të paditësit. Shfuqizohet masa e sigurimit e caktuar me Aktvendimin KE.nr.2634/22 të datës 04.01.2023, të kësaj Gjykate. Detyrohet paditësi që të paditurit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës

kontestimore në shumën e përgjithshme prej 1,227.20 € në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar paditësi, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe i ka propozuar gjykatës që të marr aktgjykim me të cilin aprovohet e bazuar ankesa e paditësit, dhe te aprovohet si e pabazuar kërkesëpadi e paditësit e përshkruar si ne padi, apo prishet Aktgjykimi ankimuar, dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje. Tutje ka deklaruar se gjykata e shkallës së parë nuk ka vendosur fare lidhur me kërkesën për shqiptimin e gjobës sipas pikës V (pese) të kërkesëpadi së precizuar te paditësit ne kuptim te nenit 75 LMT, rrjedhimisht vlerësojmë se gjykata e shkallës së parë ka vendosur ne kundërshtim me neni 143 te LPK-së me te cilin është përcaktuar se me aktgjykim gjykata vendos mbi kërkesat qe ka te beje me çështjen kryesorë dhe kërkesat aksecore, gjithashtu aktvendim i ankimuar është përfshi ne shkelje te dispozitave te LPK-se edhe sa i përket shpenzimeve te procedurës.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se

Ankesa është e **bazuar**.

Nga shkresat e lendes rrjedhe se paditësi Pandora A/S me seli në Danimarkë, përmes të autorizuarit të tij, me datën 02.11.2022, pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës, ka paraqitur padi për shkeljen e markës tregtare dhe propozim për caktimin e masës së sigurimit, kundër të paditurit D.P.Z "Bylybi", me të cilën ka kërkuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadi e paditësit dhe të konstatohet se i padituri ka shkelur markën tregtare të Pandora, me numër 013262, 018214 dhe 018068; të i ndalohe të paditurit, të përdorë, të importoj, eksportoj, të hedhë në treg çdo produkt që përmban shenjë, që është identike apo e ngjashme me markën tregtare 01362, 018214 dhe 018068, të lejohet shkatërrimi i mallrave që shkelin markat tregtare të paditësit sipas numrave të lartcekur dhe të obligohet i padituri që me shpenzimet e veta ta bëjë shkatërrimin e produkteve që bartin markën tregtare Pandora, si dhe të bëjë kompensimin e dëmit në shumën e cila do të specifikohet pas pranimit të ekspertizës financiare me kamatë ligjore prej 8%, dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Në fjalën përfundimtare, përfaqësuesja e paditësit, Agnesa Azemi — Ademi, ka deklaruar se tërhiqet nga kërkesa sipas pikës IV të padisë e cila ka të bëjë me lejimin e shkatërrimit të mallrave kontestuese, ndërsa pikën V të kërkesës e ka precizuar në atë mënyrë që ka këkuar nga gjykata që në emër të gjobës për shkeljen e markës tregtare të paditësit, t'i shqiptojë të paditurës gjobën në vlerë prej 10.000 Euro në favor të pronarit të markës tregtare, ndërsa ka mbetur pranë kërkesëpadi së sipas pikave I, II, III dhe VI të padisë,

duke theksuar që në rastin konkret nuk është kontestuese se e paditura e ka shkelur markën tregtare të paditësit. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesa e paditësit.

I padituri me përgjigje në padi, gjatë seancave gjyqësore dhe në fialën përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar që në rastin konkret mënyra se si janë rradhitur fotografitë e dorëzuara si provë me produktet e gjetura, nuk mbajnë asnjë datë, asnjë veprim, dhe asnjë konkretizim. Sa i përket këtyre fotografive konsiderojmë se përveç mos lejueshmërisë në aspektet ligjore të kësaj prove, meqenëse nuk mund të verifikohet se nga kush janë bërë këto fotografi dhe nuk dihet se kujanë bërë këto fotografi, e njejta edhe provueshmërinë e ka në dyshim. Më tutje ka theksuar që në fotografitë e paraqitura ku është paraqitur edhe një kartë-vizitë dhe një bizhuteri të cilën paditësi pretendon që e mban markën tregtare të mbrojtur, konsiderojmë që këto prova janë të papranueshme për shkak se asnjë logjikë juridike nuk e përcakton dhe nuk tregon se ky produkt me të vërtetë qenka tregtuar nga ana e të paditurit. Ka shtuar se me provat e paraqitura të cilat janë të njëanshme dhe nuk janë prova, shkeljet e markës tregtare i konstatojnë organet shtetërore dhe jo pala në mënyrë të njëanshme me pretendimet e saj me provat e parashtruara. Në fund ka theksuar që kjo padi dhe kërkesëpadi është e paprovuar, andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadija e paditësit të refuzohet në tërësi, si dhe të shfuqizohet masa e sigurimit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka specifikuar dhe atë: për përfaqësim në tri seanca shumë prej 811 ,20 € (270.40x3), për përgjigje në padi shumë prej 208.00 €, për ankesën e datës 26.01.2023 shumë prej 208.00 €, në shumë e përgjithshme prej 1,227.20 €.

Gjykata e shkalles se pare pas administrimit te provave, ka refuzuar si te pabazuar kërkesëpadija e paditësit për arsye se, me nenin 9 par. 1 të Ligjit Nr. 03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, është përcaktuar se " Inspektorati i tregut ka për kompetencë që të inspektojë standardet e tregtimit të mallrave dhe të cilësisë së shërbimeve që ofrojnë subjektet ekonomike në territorin e Republikës së Kosovës, duke e mbikëqyrë: ", ndërsa në pikën 1.9 të këtij neni, parashihet mbrojtja e të drejtave të pronësisë industriale në treg. Sipas nenit 19 par. 1 të Ligjit Nr. 03/L-181 Për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut përcaktohet se " Inspektori ndërmerr masat për procedurën inspektimit sipas detyrës zyrtare, por edhe në bazë të ankesës së palës së tretë", me par. 2 të këtij neni përcaktohet se " Ankesën e palës së tretë, Inspektori është i obliguar ta merr në konsiderim vetëm nëse ankesa paralajmëron shkelje të dyshuar për të cilën parashihet inicimi i procedurës sipas detyrës zyrtare. ", ndërsa në par.3 të këtij neni është përcaktuar që "Inspektori është i detyruar që konform paragrafit 2, të këtij neni të informojë parashtruesin e ankesës lidhur me gjendjen e konstatuar, respektivisht masat e ndërmarra në afatin ligjor. " Ndërsa për shpenzime te procedurës ka vendosur ne baze te nenit 452 parag.1 dhe 453 te LPK-së.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë sipas detyrës zyrtare e ne baze te nenit 194 te LPK e vlerëson aktgjykimin e gjykatës se shkalles se pare brenda kufijve te shkaqeve ankimore te theksuara ne ankesë, duke i vështruar sipas detyrës zyrtare shkeljet thelbësore te dispozitave te procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 nen piken b), g), j), k) dhe m) te këtij ligji dhe

aplikimin e drejte te se drejtës materiale. Dhoma e Shkallës së Dytë ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është përfshire me shkelje thelbësore te dispozitave te procedurës kontestimore nga neni 182 par.I dhe 182 par. 2 pika n) dhe o ) dhe 143 dhe 160 te LPK-së, për arsye se aktgjykimi ka te meta për shkak te cilave nuk mund te ekzaminohet, dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e aktgjykimit.

Kolegji i kësaj gjykatës me shikim e shkresave te lendes dhe procesverbalit te shqyrtimit kryesor dt. 08.12.2023 ka gjetur se, ekzistojnë pretendimet e paditësit se gjykata e shkalles se pare nuk ka vendosur për te gjitha pikat e padisë përkatësisht lidhur me kërkesën e paditësit për shqiptimin e gjobës sipas pikës V (pese) te kërkesëpadisë te paditësit ne kuptim te nenit 75 LMT, me ç ‘rast ka bere shkelje te neni 143 te LPK-së me te cilin është përcaktuar se ‘‘ *Me aktgjykim gjykata vendos mbi kërkesat qe ka te beje me çështjen kryesorë dhe kërkesat aksecore* ‘‘. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes në arsyetim të aktgjykimit është dashur ti jep të gjitha vlerësimet e saj, në lidhje me të gjitha çështjet e ngritura nga palët ndërgjyqëse. Ndërsa me rastin e hartimit të aktgjykimit është dashur të zbatojë në tërësi nenin 160 të LPK-së, përkatësisht në zbatim të parag. 4 dhe 5 të nenin të cekur më lartë, gjykata e shkallës së parë ka pasur për obligim që në arsyetim të aktgjykimit të trajtojë të gjitha kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato, përfshirë këtu dhënien e arsyetimit edhe për të gjitha çështjet tjera të ngritura nga palët ndërgjyqëse gjatë procedurës, si dhe cilat norma të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes rreth kërkesëpadisë së paditësit. Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë sipas aktgjykimit të ankimuar, tani për tani, nuk e përkrah Dhoma e Shkallës së Dytë, për shkakun se kjo gjykatë me vlerësimin dhe analizimin e tërësishëm të shkresave të lëndës ka gjetur se aktgjykimi i ankimuar është marrë me shkeljet thelbësor te dispozitave ligjor edhe vërtetimi jo te plot dhe te gabuar te gjendjes faktike dhe si rezultat i kësaj tani për tani edhe me zbatim te gabuar te drejtës materiale për të cilën gjykata e shkallës së dytë çdo herë kujdeset sipas detyrës zyrtare ne kuptim te nenit 194 të LPK dhe e cila shkelje sipas vlerësimit të kësaj gjykate ka ardhur si shkak shkeljeve thelbësore te procedurës kontestimore, vërtetimit jo te plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike me rastin e vendosjes nga ana e gjykatës se shkallës së parë.

Gjykata vlerëson se arsyetimi i vendimit kontestues është i mangët dhe nuk i ka elaboruar çështjet dhe faktet vendimtare që kanë të bëjnë me këtë çështje juridike. Në rastin konkret nga dispozitivi i aktgjykimit të kontestuar gjykata e shkallës së parë nuk ka vendosur për te gjitha pikat e padisë, andaj kolegji i kësaj gjykate konsideron se dispozitivi i aktgjykimit është i mangët i paqartë dhe kundërthënës me vetvete, nga çka rezulton se gjykata e shkalles se pare ka bere shkelje te dispozitës se nenit 160.3 me te cilën është përcaktuar se dispozitivi i aktgjykimit nder te tjera duhet te përmbaj vendimin me te cilin aprovohet apo refuzohet kërkesat qe kane te bëjnë me çështjen kryesorë dhe aksesore. Shkeljet e tilla përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që kanë pasur ndikim në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë andaj aktgjykimi i atakuar, doemos është dashur të priset. Gjykata e shkallës së parë, ne ri

procedurë duhet ti shqyrtojë të gjitha vërejtjet e dhëna nga kolegji i kësaj gjykate, ti eliminoj të gjitha shkeljet e theksuara më lartë, të vendos në kuptim të nenit 160 të LPK-së, ashtu që dispozitivi dhe arsyetimi i vendimit të jetë i çartë dhe i kuptueshëm, të vendos për të gjitha kërkesat e palëve në procedurë, ti vlerësoj të gjitha provat veç e veç dhe të gjitha së bashku, dhe në fund të merr vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Lidhur me pretendimet ankimore përkitazi me shpenzimet e procedurës, kolegji ka vendosur që të priset edhe pjesën lidhur me shpenzimet e procedurës të njohura paditurës, pa u lëshuar fare në ligjshmërinë e kësaj pjesë të aktgjykimit të ankimuar, për faktin se, kjo lëndë është dashur që të priset dhe gjykatës së shkallës së parë t'i kthehet në rigjykim, me çka pranë asaj gjykate ne procedurën e rigjykimit do të krijohen edhe shpenzime tjera procedurale, për të cilat gjykata e shkallës së parë duhet të vendosë me rastin e marrjes së vendimit përfundimtar, duke shqyrtuar pretendimet e palëve ne procedure dhe duke pasur parasysh suksesin e palëve në procedurë dhe kush u ka dhënë shkas krijimit të shpenzimeve procedurale.

Për arsyet e lartë cekura, aktgjykimi i kundërshtuar është dashur të priset dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, për t'i mënjeluar shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore të theksuara më lartë, e që janë të tilla që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktgjykimit të goditur. Pas eliminimit të këtyre të metave të lartecëkuar të vërtetohet drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendja faktike, duke i vlerësuar më pas edhe të gjitha pretendimet tjera të palëve të paraqitura në shqyrtimin kryesor, por të përsëritura edhe me ankesë, si dhe duke dhënë arsyetim të mjaftueshëm për këto pretendime, dhe mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, të sjell një vendim të ligjshëm dhe të drejtë, dhe një dispozitiv të qartë, të kuptueshëm dhe të përmbarueshëm. Pas vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike dhe mënjanimi të shkeljeve esenciale të lartpërmendura, gjykata e shkallës së parë ka mundësi të bie aktgjykim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga te cekurat me lart, e në mbështetje të nenit 194, 195 parag. 1 pika (c) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË**

Dhoma e Shkallës së Dytë

Kom.Dh.Sh.II.nr.972/24 me datë 04.07.2023

**Kryetari i Kolegjit, gjyqtari  
Ramush Bardiqi d.v.**